



## **KOMUNIKATË**

### **2.02.2010**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti sot mbledhjen e 12-të në të cilën KQZ u informua lidhur me seancën dëgjimore në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si dhe për aktivitetet e ZRPP-së dhe të QNR-së. Kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, ka kërkuar nga anëtarët e KQZ-së miratimin e rendit të ditës. Pas miratimit të rendit të ditës, kryetarja Nesrin Lushta, e ka njoftuar KQZ-në për seancën dëgjimore në Gjykatën Kushtetuese. KQZ do të përgatitet për këtë seancë këto ditë, deri më 9 shkurt kur edhe do të mbahet seanca.

Kryeshefi i SKQZ-së z. Xhemajl Peqani, e informoi KQZ-në se në orën 00.45 minuta, është bërë pranimi i materialit të ndjeshëm nga komuna e Lipjanit nga 71 vendvotime. Materiali është pranuar në gjendje të rregullt dhe, është proceduar në QNR. Materiali i ndjeshëm nga komuna e Prizrenit, është sjellur në gjendje të rregullt nga 198 vendvotime. Edhe ky material, është proceduar në QNR. Në karantinë janë vendosur në 5 kuti të vendvotimeve që kanë pasur parregullsi. Dy kuti janë nga komuna e Lipjanit dhe, tri kuti janë të komunës së Prizrenit.

Zyra për Regjistrimin e Partive Politike, e informoi KQZ-në se më 27 janar 2010, iniciativa politike e quajtur Demokratska Alternativa (DA), e udhëhequr nga z. Dragan Stojkoviq nga Mitrovica, ka dorëzuar aplikacionin për regjistrim. Zyra pas kontrollimit të dokumentacionit, i ka dhënë afat ligjor për plotësimin e Statusit sipas rregullës së KQZ-së nr. 01/2008 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike. Gjithashtu, më 20 janar 2010, një iniciativë e re politike e quajtur Partia Pensioniste dhe e Invanidëve (PPI) e komunitetit shqiptar, i udhëhequr nga z. Lush Isufaj nga Prishtina, ka aplikuar për regjistrim. Zyra, e ka në proces të shqyrtimit dokumentacionin e sjellur.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjithashtu është informuar nga Zyra Ligjore për zëvendësimin e këshilltarëve komunal. Zyra Ligjore, ka raportuar për zëvendësimin e 2 këshilltarëve nga komuna e Graqanicës.